



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

Nr. 1141 / 19 prot.

Tiranë, më 21.06.2021

UDHËZIM

Nr. 05 datë 21 /06/2021

MBI

PËRJASHTIMIN NGA TATIMI MBI VLERËN E SHTUAR NË KUADËR TË RINDËRTIMIT

Mbështetur në nenin 479 të Vendimit nr.651, datë 10.11.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr.102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar; nenet 53, shkronjat “I” e “II”, dhe 56, pika 28 të ligjit nr. 92/2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar; VKM Nr.143, datë 29.12.2014, “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 92/2014, “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar;

Bazuar në pikën 1/b/i, të pjesës VIII/1, të Vendimit nr.921, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për personelin e administratës doganore”, i ndryshuar;

Me qëllim zbatimin korrekt të legjislacionit mbi mallrat që hyjnë në territorin doganor të Republikës Shqipërisë në kuadër të rindërtimit, të cilat do të importohen me përjashtim:

U D H Ë Z O J:

I - KUSHTET E PËRGJITHSHME

1. Përjashtimi nga TVSH-ja për qëllime të procesit të rindërtimit zbatohet për mallrat e deklaruar:
 - a) për herë të parë për qarkullim të lirë, ose
 - b) për qarkullim të lirë, pasi kanë qenë objekt i një regjimi tjetër doganor.
2. Për përjashtimet e mallrave të vendosura në qarkullim të lirë, sipas një përdorimi të përcaktuar, nuk lejohet përdorimi për qëllime të tjera, pa kryer pagesën e detyrimit të TVSH-së në import.
3. Autoriteti kompetent për dhënien e përjashtimeve është Drejtoria Përgjithshme e Doganave, sipas kriterëve, kushteve dhe dokumentacionit të referuar në legjislacionin në fuqi dhe në pjesën II, të këtij udhëzimi.

II. KUSHTE TË VEÇANTA

1. Ndërtuesit, subjekte të rindërtimit (neni 4 VKM Nr. 143, datë 13.2.2020)

Baza ligjore: Nenet 53, shkronjat “I” e “II”, dhe 56, pika 1, të ligjit nr. 92/2014, “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
VKM Nr. 143, datë 13.2.2020 “Për procedurat për lëshimin e autorizimit, për subjektet e rindërtimit dhe për përjashtimin nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar të furnizimit të mallrave e shërbimeve, për qëllime të procesit të rindërtimit”

Përfitues: Subjektet që importojnë mallra për procesin e ndërtimit dhe që pajisen me autorizim nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për çdo kontratë që do të realizojnë sipas nenit 4 të VKM Nr. 143, datë 13.2.2020.

Procedura: E thjeshtuar (pa autorizim përjashtimi).

Objekti i përjashtimit: Mallrat që do të importohen në kuadër të rindërtimit.

Dokumentacioni i nevojshëm:

- Kërkesë me shkrim ku të jetë evidentuar NIPT/NUIS për përjashtimin në import për zërat përkatës;
- Autorizim nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve për përjashtimin nga TVSH-ja me sasinë mallrave që do të importohen, për çdo kontratë rindërtimi e cila i bashkëngjitet kërkesës;
- Lista e mallrave të cilat do të importohen (lloji dhe sasia).

Njësia zbatuese e procedurës së thjeshtuar: Drejtoria e Tarifës dhe Originës.

Drejtoria e Tarifës dhe Originës, Sektori i Tarifës pasi shqyrton kërkesën e subjektit dhe verifikon dokumentacionin bashkëngjitur. Subjekti mund të dërgojë dokumentacion plotësues në email-in zyrtar: starifa.dpd@dogana.gov.al.

Sektori i Tarifës procedon më tej me kryerjen e regjistrimit të NUIS në sistemin Asycuda World me kodin shtesë:

Kodi i procedurës shtesë, kutia 37.b (DAV): RND (përjashtim vetëm nga TVSH)

2. Materialet, pajisjet, ndërtesat e parafabrikuara, të importuara nga organet shtetërore, organizatat bamirëse dhe filantropike

Baza ligjore: Nenet 53, shkronjat “I” e “II”, dhe 56, pika 1, të ligjit nr. 92/2014, “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
VKM Nr. 143, datë 13.2.2020 “Për procedurat për lëshimin e autorizimit, për subjektet e rindërtimit dhe për përjashtimin nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar të furnizimit të mallrave e shërbimeve, për qëllime të procesit të rindërtimit”

Përfitues: Organet shtetërore, organizata bamirëse dhe filantropike që importojnë Materialet, pajisjet, ndërtesat e parafabrikuara për procesin e ndërtimit sipas nenit 5 të VKM Nr. 143, datë 13.2.2020.

Procedura: Me autorizim përjashtimi lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Objekti i përjashtimit: Materialet, pajisjet, ndërtesat e parafabrikuara, të importuara nga organet shtetërore, organizatat bamirëse dhe filantropike në kuadër të rindërtimit sipas nenit 5 të VKM Nr. 143, datë 13.2.2020.

Dokumentacioni i nevojshëm:

- kërkesën me shkrim, ku të jetë evidentuar NIPT/NUIS;
- dokumentin e lëshuar nga njësi zbatuese ose nga organi kompetent përkatës, sipas legjislacionit për rindërtimin, ku provohet/vërtetohet se materialet, pajisjet, ndërtesat e parafabrikuara, sipas zërave dhe sasive përkatëse, janë të destinuara për rindërtimin e zonave të fatkeqësive, për rastet e shpalljes së “gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, brenda programit të rindërtimit.

Njësia zbatuese e procedurës: Drejtoria e Tarifës dhe Origjinës.

Drejtoria e Tarifës dhe Origjinës, brenda pesë ditëve pune nga data e dorëzimit të dokumentacionit, shqyrton aplikimin për përjashtim. Nëse konstatohen mangësi në dokumentacion, njoftohet kërkuesi për mangësitë e konstatuara dhe për plotësimin e dokumentacionit brenda një afati pesëditor duke i dërguar në email-in zyrtar: *starifa.dpd@dogana.gov.al*. Me plotësimin e dokumentacionit, DPD-ja lëshon autorizimin për përjashtim, i cili regjistrohet në sistemin Asycuda World me kodin shtesë:

Kodi i procedurës shtesë, kutia 37.b (DAV): RND (përjashtim vetëm nga TVSH)

III. ZBATIMI DHE HYRJA NË FUQI

Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Drejtoria e Tarifës dhe Origjinës.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Genti GAZHELI
DREJTOR I PËRGJITHSHËM

